

L I G J
Nr.7499, datë 6.7.1991

PËR RIVENDOSJEN E GRADAVE USHTARAKE NE FORCAT E ARMATOSURA TE
REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Ne mbështetje te nenit 16 te ligjit nr.7491 datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I :

Neni 1

Ne forcat e armatosura te Republikes se Shqiperise rivendosen gradat ushtarake.

Neni 2

Gradat ushtarake Për oficeret aktive e rezerviste te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise ndahen ne :

- a) Grada te uleta (nentoger,toger)
- b) Grada te mesme (kapiten,kapiten I)
- c) Grada te larta (major-kapiten i rangut te trete)
nenkolonel-kapiten i rangut te dyte)
kolonel-kapiten i rangut te pare)
- ç) Grada madhore (gjeneralmajor-kunderadmiral
gjenerallejnant-nenadmiral
gjeneralkolonel-adminiral
gjeneralarmate.

Neni 3

Gradat ushtarake Për ushtaret e sherbimit te detyrueshme te ngarkuar me funksione drejtuese ndahen ne:

- Tetar dhe Reshter (tetar-kryetar)
- Gradat ushtarake Për nenoficeret aktive e rezerviste ndahen:
- Kapter dhe kapter i pare (kapter-.miçman)

Neni 4

Format konkrete e seciles grade te jete sipas albumit te miratuar nga Keshilli i Ministrave

Neni 5

Për secilen grade, me vendim te Keshilli te Ministrave caktohet edhe nje mase e vecante shperblimi qe jepet mbi pagen mujore te ushtarakut.

Neni 6

Gradat ushtarake si rregull, u jepen ushtarakeve sipas funksioneve organike perkatese,arsimit, kualifikimit, meritave te vecanta gjate kryerjes se sherbimit e detyres dhe vjetersise ne sherbim.

Grada e fituar ruhet edhe me levizjen e ushtarakut ne funksion organik me grade me te ulet.

Neni 7

Koha e vjetersise Për kerkimin e grades ushtarake te zekonshme Për oficeret eshte :

- Nga nentoger ne toger 2 vjet
- Nga toger ne kapiten 3 vjet
- Nga kapiten ne kapiten i pare 4 vjet
- Nga kapiten i pare ne major 4 vjet
- (nga kapiten i pare ne kapiten te rangut te trete)
- Nga major ne nenkolonel 5 vjet
- (Nga kapiten i rangut te trete ne kapiten te rangut te dyte)
- Nga nenkolonel ne kolonel 5 vjet
- (Nga kapiten i rangut te dyte ne kapiten te rangut te para)

Neni 8

Gradat ushtarake u jepen oficerëve me urhder, perkatesisht te Ministrit te Mbrojtjes, te ministrit te Rendit Publik dhe te kryetarit te Sherbimit Informativ Kombetar.

Kriteret e vecante Për dhenien e gradave ne strukturat perkatese (duke perjashtuar ato madhore) caktohen nga Keshilli i Ministrave.

Neni 9

Gradat ushtarake madhore, sipas pikes "ç" te nenit 2, jepen ne dekret te Presidentit te Republikes, mbi bazen e propozimit te Këshillit te Ministrave.

Neni 10

Grada e pare Për oficeret e sapotitulluar, si regull eshte nentoger. Perjashtim behet Për ata qe mbarojne shokollat me rezultat te shkelqyer, grada e te cileve eshte nje shkalle me e larte se grada e pare.

Neni 11

Gradimi jashte rradhe i oficerëve (me perjashtim te oficerëve madhore) Për merita te vecanta sherbimi ndaj Atdheut si dhe i atyre qe dallohen Për rezultatet te larta ne detyrat funksionale e ne pergatitjen ushtarake, behet me urdher te ministrit te Mbrojtjes, te ministrit te Rendit Publik dhe te kryetarit te Sherbimit Informativ Kombetar.

Neni 12

Ministri i Mbrojtjes, ministri i Rendit Publik dhe kryetari i Sherbimit Informativ Kombetar, Për thyerje te renda ose te perseritura te disiplines ushtarake dhe Për paaftesi ne detyre kane te drejte tu ulin oficerëve graden gjen ne nje shkalle.

Neni 13

Gjeneraleve dhe admiraleve u ulet grada ushtarake, sipas rastit, me dekret te Presidentit te Republikes se Shqiperise, ne baze te propozimit te Këshillit te Ministrave.

Neni 14

Oficeret e dale ne pension pas vendosjes se gradave ushtarake, gezojne te drejten e mbajtjes se nje uniforme ushtarake liridalje, se bashku me graden e fundit te funksionit organik, te cilen e veshin

vetem ne raste festash zyrtare.

Neni 15

Dekreti nr.4113, datë 7.3.1966 " Mbi heqjen e sistemit te gradave ne Forcat e Armatosura te Republikes Popullore te Shqiperise shfuqizohet.

Neni 16

Ky ligj hyn ne fuqi me 28 Nendor 1991.

PRESIDENTI I REPUBLIKES
RAMIZ ALIA